



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Dibran Shala nga Skenderaj rruga “Adem Shala”nr.50, 41000 Republika e Kosovës

E PADITUR:REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 1310000 €

1.)Paditësi Dibran Sh. është baba i birit te ndjerë Musli Shala i cili është marruar ne shtëpi, është ndarë nga familja duke e torturuar ne mënyrë ç’njerezore pastaj është masakruar ne Skenderaj ne vendin e quajtur tek pishat me datën 20.04.1999

Provë : - Vërtetimi nga ana e D.SH.M.S. në Skenderaj 09 nr.580 të datës 17.12/0 -
- Deklarata për bashkësinë familjare sipas numrit rendor 035-20036 e datës 24.12.2009

2.) Paditësi me anëtarët e familjes është pasardhës juridik i sendeve te luajtshme dhe te pa luajtshme te cilat janë krijuar nga puna e përbashkët dhe trashëgimia , kjo patundshmëri përbehet prej shtëpisë me sipërfaqe prej 234 m² , shtëpia nuk është djegur por është demoluar tersisht dhe i ter interieri shtëpiak,duke përfshirë teknikën e bardhe dhe mobilierinë e 7 dhomave te gjumit,pastaj,traktorit ,veturës,dhe bagëtinë prej 3 krer 2 lopë dhe një mushtjerr dhe gjerave tjera si shtëpia e te gjallit .

Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt.26.12.2008, nr. 580 -12
- Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme UL – 72015007-00078 e 23.12.2008
- Çeku i fundit i pensionit për muajin shkurt 1999
- Dëshmia për veturën “jugo 55”
- Dëshmitarët e propozuar për traktor;
1.Enver Shala f.sh.Burojë dhe
2.Enver Osmani nga f.sh.Klladernicë Komuna e Skenderajt.

3.) Viktimës nga forcat ushtarake policore serbe të udhëhequra direkt prej qeverisë se Serbisë e cila ka kryer veprime gjenocidiale , krime kundër njerëzimit,i është shkatërruar pasuria , është detyruar ta braktis vendbanimin se bashku me fëmijët ne kohë zgjatje prej 3 muaj e 15 ditë.

Dibran Shala paraprakisht është larguar dhunshëm nga vendi i punës sekretar i shkollës së mesme teknike “Anton Çetta” ne Skenderaj nga data 15.06.1991 nga ana e administratës së dhunshme serbe ashtu qe i është pamundësuar, andaj i është pamundësuar marrja e pagës deri ne vitin 1998 kur e fiton te drejtën ne pension te pleqërisë,ndërsa nga muaji shkurt 1999 i ndalet edhe pensioni i pleqërisë.

Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt.26.12.2008. , nr. 580 – 12

- Vërtetimi i shkollës teknike “Anton Çetta” nr.1878 i datës 16.04.2009

- Çeku i fundit i pensionit për muajin shkurt 1999

Dëgjimi i paditësit dhe dëshmitarëve te propozuar si dhe provave te tjera te cilat paditësi do ti prezantoj ne seancat e shqyrtimit kryesor dhe ne rast nevojje te caktohet edhe eksperti përkatës

4.) Të drejtën për kompensim padis e bazon në nenin 185 te LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 te te njëjtit Ligj , me te cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë te personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në ketë rast e paditura ka qen e obliguar te pengoj aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes se pasurisë se paditësit. .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (neni 1 Protokolli nr. 1 , neni 2 dhe protokolli nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor te çështjes , t’i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

pastaj të bien këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesë padija e paditësit Dibran Shala me vendbanim në Skenderaj rr.”Adem Shala”nr.50 , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë -Qeveria e R.S. si pasardhëse juridike e Qeverisë se me parshme qe ne emër te te njëjtës te kompensoj demin material dhe jo material paditësit Dibran Shala me vendbanim në Skenderaj , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 900 000 €për torturë ç’njerzore dhe masakrim te djalit Musli Shala
- shumen prej 16 800 €për dhembjen shpirtërore dhe te munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi ne qiell te hapur dhe shtëpi te huaja gjatë kohës prej 3 muaj e 15 ditë
- shumen prej 300 000 për shkak te pamundësuarit e kremtimit te festave fetare ne shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
- shumen prej 20 000 €për renovim te shtëpisë së demoluar tersisht.
- shumen prej 60 200 €për teknikën e bardhe në sallon mobilierinë e 7 dhomave te gjumit si dhe bagëtinë prej 3 krer,2 lop dhe 1 mushtjerr.
- shumen prej 13 000 €për traktorin dhe e veturën e marruar.
- shumen prej _____ €për pamundësimin e shfrytëzimit te tokës bujqësore për tri vite.

te gjitha këto shuma me kamatë ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .


Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysht gjendjen e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi
Dibran Shala


Shtojcë :

- 1.Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt. 26.12. nr. 580 – 12
2. Deklarata për bashkësinë familjare Nr. 035-20036 e datës 24.12.2009
3. Vërtetimi nga ana e D.SH.M.S. në Skenderaj 09 nr.580 të datës 17.12/08
4. Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme UL – 72015007-00078 e datës 23.12.2
5. Vërtetimi i shkollës teknike “Anton Çetta” nr.1878 i datës 16.04.2009
6. Çeku i fundit i pensionit për muajin shkurt 1999
7. Deshmia për veturën “jugo 55”
8. 4 kopje te padisë